

AFËRDITA ABDULLAHI

**VEÇORI TË FJALËFORMIMIT NË GEGËRISHTEN E KOSOVËS
PERËNDIMORE DHE JUGPERËNDIMORE**

Gjuha ndodhet në një proces të pandërprerë zhvillimi, pasi ajo ka lindur bashkë me njerëzimin si një mjet shumë i rëndësishëm komunikimi dhe bashkë me të ndryshon, zhvillohet në mënyrë të pandërprerë duke pasqyruar ndryshimet në veprimtarinë shoqërore, politike, ekonomike, kulturore dhe shkencore të vetë shoqërisë që e flet atë. Këto ndryshime dhe evoluime, pasqyrimin e tyre të drejtpërdrejtë dhe të shpejtë e gjejnë veçanërisht në leksikun e gjuhës. Një nga rrugët për zgjerimin e leksikut është fjalëformimi¹.

Prandaj, shembujt konkretë të fjalëformimit i ndeshim më shumë në rajonin e Kosovës Perëndimore dhe Jugperëndimore. Këto rajone pra, Kosova Perëndimore dhe Jugperëndimore, në fushën e leksikut veçohet edhe me fjalëformim. Në këto pjesë do të trajtojmë fjalëformimin në bazë të fjalëve, që na ndihmon të kuptojmë se këto krahina kanë edhe shumë tipare dalluese nga pjesa tjetër.

Në tërësinë e leksikut të kësaj treve, emërtimet që i përkasin sferës së blegtorisë dhe asaj të bujqësisë, dallohen më tepër nga sferat e tjera, si për dëndurinë e përdorimit, ashtu edhe sasinë më të madhe të fjalëve.²

Kur ndërtohet një fjalë, gjuha vë në lëvizje një mekanizëm të ndërlikuar për emërtim, sepse do të shënohet një kuptim dhe do të formësohet fjala që të jetë e përshtatshme për trajtat si pjesë e ligjëratës. Fjalëformimi në përgjithësi, as nuk mund të merret me mend nëse nuk vështrohet nga prizmi dialektor, sepse gjuha letrare do të ishte e varfër në këtë çështje pa mbështetjen e fortë në mënyrën e formimit të fjalëve nëpër dialekte³. Në fushën e fjalëformimit kjo e folme gjithashtu paraqet interes të veçantë për t'u studiuar, si për larminë e madhe të elementeve fjalëformuese, ashtu dhe për mënyrën e bashkimit të tyre në fjalë të ndryshme të leksikut të këtyre tërthoreve⁴. Fjalëformimin e kësaj idiome

¹ Doktorata e Migena Sejдини, internet.

² B. Mehmetaj, *E folmja e Deçanit me rrethinë*, IAP, Prishtinë, 2006, f. 125.

³ I. Badallaj, *E folmja e Hasit*, Prishtinë, 2001.

⁴ Q. Murati, *Studime gjuhësore II*, IAP, Prishtinë, 1989, f. 146.

perëndimore dhe jugperëndimore të gjuhës shqipe e karakterizon një larushi e tërë dhe e shumëllojshme për nga struktura fjalëformuese e elementeve të ndryshme leksiko-gramatikore. Fjalëformimi është ajo degë që merret me përshkrimin, ndërtimin e strukturuar të fjalëve.

Janë tri anë që kanë interes për shprehësinë e fjalëformimit:

- E para – mjetet dhe mënyrat e fjalëformimit,
- E dyta – marrëdhëniet e fjalëve nga ana fjalëformuese,
- E treta – vetë fjalët e reja që lindin (neologjizmat).⁵

Të gjitha këto fjalë përfshihen në dy grupe të mëdha: në fjalë të parme dhe jo të parme.

Fjalë të parme

Te fjalët e parme ose të pamotivueshme temat janë të pazbërthyeshme morfologjikisht, d.m.th. kuptimi i tyre buron nga kuptimi i ndonjë teme tjetër. Ato përbëhen vetëm prej një morfeme dhe përputhen me rrënjën e fjalës. P.sh.: *lis, i zi, i lartë, i kaltër, det, pyll, i ri*, etj.

Fjalë jo të parme me prejardhje

Prejardhja është mënyra më prodhimtare dhe më e larmishme në sistemin e fjalëformimit të shqipes⁶. Prejardhje quhet formimi i fjalëve të reja me anë të bashkimit të ndajshesave fjalëformuese me tema fjalësh ose me fjalë. Këto vende janë mjaft të pasura me fjalë të prejardhura, të krijuara kryesisht me prapashtesa, e më pak me parashtesa. Aleksandër Xhuvani dhe Eqrem Çabej në studimin e tyre mbi parashtesat dhe prapashtesat, kanë identifikuar 68 parashtesa dhe 168 prapashtesa të shqipes⁷.

Formimi i fjalëve të reja me anën e parashtesave në këtë të folme është mjaft produktiv, por jo aq sa edhe me prapashtesa, ngase formimi prapashtesor është shumë i madh.⁸ Parashtesat e gjuhës shqipe, si sasi janë rreth një e treta e prapashtesave dhe veç kësaj nuk e kanë prodhimtarinë e këtyre të fundit, megjithatë parashtesimi është një nga mënyrat më të rëndësishme e më të gjalla të fjalëformimit të shqipes⁹.

Parashtesat më të njohura në këto të folme janë: *ç, k, kaca, kala, m, n, pa, para, për, po, s, sh, shpër, t, z, zh*, etj.

⁵ Xh. Lloshi, *Njohuri për stilistikën e gjuhës shqipe*, Rilindja, Prishtinë, 1989, f. 110.

⁶ *Gramatika e gjuhës shqipe I*, Tiranë, 2002.

⁷ A. Xhuvani, E. Çabej, *Parashtesat e gjuhës shqipe*, në “Studime gjuhësore” III, Prishtinë, 1987.

⁸ I. Badallaj, *E folmja e Hasit*, Prishtinë, 2001.

⁹ *Gramatika e Gjuhës Shqipe*, Tiranë, 2001.

Parashtesa ç

Parashtesa ç – e cila në disa raste përdoret edhe si *sh*, formon shumë fjalë: *çmoth*, *çlodh*, *çkomcoj*, *çaj*, *çnderoj*, *çmontim*, etj. Ndërsa këto fjalë mund të dalin edhe me parashtesën *sh*: *shlodh*, *shçaj*, *shmontoj*, etj.

Parashtesa ka

Me këtë parashtesë formohen shumë emra, mbiemra, e folje, si: *kaleshan* (prej leshit), *kablush* (lopës balushë), *kadale* (ngadalë).

Parashtesa kaca/kaça

Tek kjo parashtesë mund të dalin fjalët edhe me parashtesën *kaca/kaça*. Kemi fjalët, *kacavjerr*, p.sh. (ish pat met kacavjerrun n'rrem) Parashtesa ç – e cila në disa raste përdoret edhe si, modeli fjalëformues i këtyre fjalëve është *kaca + tF – F* (*kacavar*), ose *kaça + tE – E* (*kaçadrë*).¹⁰

Parashtesa kala

Me këtë parashtesë kemi formime të emrave si: *kalavesh* (përdoret zakonisht kalaveshi i rrushit, por tani fjala *kalavesh* përdoret edhe në mënyrë satirike), *kaladredhan* (zakonisht për fëmijët që janë më të lazduar, nga fjala përkëdhelëse *dredhan*), *kalafuc*, etj.

Parashtesa m

Fjalët e formuara me parashtesën *m*, janë mjaft të njohura, kryesisht formohen emra si: *mshtjerr* (shtjerr), *msysh* (sysh), *mërdhez* (dhez) etj.

Prapashtesimi

Siç e përmendëm edhe më lart, fjalët më shumë formohen me prapashtesim. Në pajtim me karakterin e saj gjuhësor, shqipja është më e pasur në prapashtesa se në parashtesa.¹¹ Duke u munduar që t'i radhisim fjalët e formuara me prapashtesim të cilat kanë përdorim më të shpeshtë, po i japim disa prej këtyre prapashtesave: *-acak*, *-aj*, *-an*, *-ejk*, etj.

Prapashtesa - acak

Ka edhe emra dhe mbiemra që janë formuar me këtë prapashtesë. Kryesisht komuna e Deçanit, siç njihen fjalët: *guracak*, *mullacak*, *ethacak*, *fushacak*, *rrenacak*, etj.

Prapashtesa – aj

Zakonisht me këtë prapashtesë formohen mbiemrat, siç janë: *Lekaj*, *Pepaj*, *Molaj*, *Guraj*, *Dushkaj*, etj.

Prapashtesa – an

¹⁰ N. Berisha, *Leksiku dhe frazeologjia në fshatrat e Gjakovës*, punim masteri, Prishtinë, 2016, f. 32

¹¹ E. Çabej, *Studime gjuhësore III*, Prishtinë, 1987.

Me këtë prapashtesë formohen një numër i madh fjalësh, sidomos grupe emrash që të gjithë të gjinisë mashkullore. Karakteristikë e tyre është se një masë të konsiderueshme ato përdoren me kuptim pezhorativ, si: *morran-* (njeri me), *rreban-* *rrenacan*, *çyçan*, *sorran*, *breshkan*, *balushan*, *bacan*, etj.

Prapashtesa – ejk

Kjo prapashtesë e cila është sllavishte, ka përdorim mjaft të gjerë. *Terpiejk* (dikush që han shumë), *spirejk* (që është më i dobët), *tucejk* (frikacake), *vjedhcejk* (hajneshë), etj.

Fjalët e përbëra – kompozimi

Fjalë e përbërë ose kompozitë e mirëfilltë në shqipe është ajo fjalë dygjymtyrëshe që formohet nga bashkimi i dy ose më shumë temave në një fjalë të vetme, në një njësi të vetme leksiko-semantike strukturalisht të mbyllur, e cila formësohet si një tërësi e pavarur fonetiko-morfologjike, ka kategoritë e veta potenciale fjalëformuese, zhvillohet semantikisht dhe kryen funksionet e veta sintetike si një tërësi fjale, pavarësisht nga veçoritë fonetike dhe leksiko-gramatikore të komponentëve të saj¹².

Sipas Gramatikës së gjuhës shqipe, kompozitat formohen kryesisht nga emra e mbiemra dhe nga një numër i vogël foljesh e ndajfoljesh. Pjesët e tyre mund të jenë tema emërore, mbiemërore, foljore ose ndajfoljore: *belhollë*, *buzëqesh*, *duarartë*, *fjalëshumë*, *keqkuptoj*, *qafëgjatë*, *syshqiponjë*, *zemërgur*¹³. Në të folmen e krahinave të Rrafshit të Dukagjinit kompozitat apo fjalët e përbëra zakonisht formojnë emra dhe mbiemra. Dallojmë:

- Kompozitat këpujore (fjalë të përbëra me lidhje bashkërenditëse). Këto fjalë formohen me tema duke e plotësuar njëra-tjetrën:
 - *Turravrap* (turra + vrap);
 - *Vajtjeardhje* (vajtje + ardhje);
- Fjalët e përbëra me lidhje nënrenditëse. Te këto fjalë temat e përcaktojnë njëra tjetrën:
 - *Gojshiqere* (gojë + sheqere). *A moj çikë po goja sheqer po t qitka, gojë sheqerja që koke.*
 - *Bojpeme* (bojë + pemë).
 - *Komkajusha* (këmbë + kajusha).
 - *Lulbostoni* (lule + boston).

¹² A. Kostallari, *Mbi disa veçori të fjalës së përbërë në gjuhën shqipe në studime mbi leksikun*, Tiranë, 1972, f. 83.

¹³ J. Thomai, *Leksikologjia e gjuhës shqipe*, Prishtinë, 2000.

- *Baballoqi* (baba + lloq, fshat).

Dallojmë:

- emër + pjesore, si p.sh.: *ballëdalun* (ballë + dalë, Suharekë), *leshdredhun* (lesh + dredhur),
- emër + folje, p.sh. *dredhalesh* (dredhë + lesh), *dashamiri* (dash + i mirë), *hekakeqi* (hjek + keq),
- emër + mbiemër, p.sh.: *veshbardhë-a* (dele e zezë me vesh të bardhë), *bribledhta* (kafshë me brirë të afruar, të mbledhur), *brihapta* (kafshë me brirë të larguar dukshëm), *cicvogla* (kafshë me cica të vogla), *ftyregra* (dele që leshin e turinit e ka të egër), *barkthatë* (grua sterile), *dhamshtrëmte* (dhamçatall - Xërxë), *punkeqeja* (punë + keq, Junik), *dorhollë* (dorë + hollë, Voksh), *musteçbardhi* (musteqe + e bardhë), *sykeqi* (sy + i keq), *syzi* (sy + zi), *sygemti* (sy shtrembëri).
- emër + emër, p.sh.: *gurapeshë* (gurë + peshë, Voksh, Deçan), *ballagushe-ja* (ballë + gushë “ballagushja nanës”, Suharekë), *barkëdreç* (“puno more fatkeq e ha more barkëdreç”, Suharekë), *pikaveshe* (dele me pika të dalluara nëpër vesh), *xhicakulle* (dele me gjinj të mëdhenj e cica të zgjatura).

Përngjitja – konversioni

Përngjitja është një mënyrë fjalëformimi me anë të së cilës formohen fjalë të reja nga njëfjalëzimi i një togfjalëshi, i një togu parafjalor, ose i një grupi fjalësh në përgjithësi.¹⁴ Fjalët e tilla të formuara me përngjitje zakonisht i ruajnë lidhjet sintaksore ndërmjet gjymtyrëve. Sipas profesor Jani Thomait, fjalët e përngjitura janë formuar historikisht nga ngjitja a nga bashkimi i dy ose më shumë fjalëve gjatë përdorimit të tyre pranë njëra-tjetrës.

- Me përngjitje kemi ndajfolje: *mozomakeq* (mos + o + Zot + ma + keq), *herdoku:r*, (her + do + kur), *obu* (o + burr), *hamadreq* (hae + ma + dreq), *tonaheret* (të + gjitha + herët), *tekderni* (tek + deri + në + një), *çoshemçoshe* (çoshi me çosh), *veshemvesh* (vesh + vesh), *hapekrah* (krahë hapur).
- Emra: *Kushtrim* (kush është trim), *Hamadreq*, (ta hajë dreqi).
- Përemra: *pakkush* (shumë pak njerëz), *shumkush*, (e kundërta).
- Parafjalë: *maton* (më larg), *përsipri*, (përmbi), *përfuni* (nër).
- Numëror: *dymdhet* (dymbëdhjetë), *tremdhet* (trembëdhjetë), etj.

¹⁴ *Gramatika e gjuhës shqipe*, Tiranë, 2000, f. 158.

Paranyjëzimi (nyja e përzier)

Paranyjëzimi është formimi i fjalëve duke i shtuar një teme ose një grupi fjalësh një nyjë përpara, si p.sh.: larguar – i larguar, pa punë – i pa punë, etj.

Nyjat e përziara zakonisht dalin përngjitje + prapashtesim (*pesdinarsh* – pesë + dinarë + sh), (*shtatmujsh*-shtatë +muj +sh); (*katërçoshsh*-katër + çosh + sh) dhe kompozim + prapashtesim (*berrejshëm*– be + rrena + shëm); (*hapakomaz* – hap + këmbë + az); (*komdredhejk* - këmbë + dredhë + ejk), (*mozomakeq* - mos + zot+ ma + keq).

PËRFUNDIME

Duke konsideruar shtjellimin sa më të mirë të leksikografisë në këto rajone, mund të themi që leksiku i gjuhës shqipe është temë mjaft e gjerë. Ai përfshin në vetvete një korpus të madh fjalësh, duke filluar nga ato lokale, krahinore e dialektore, deri te fjalët e hyra në shqipen standarde. Përveç bukurive të mëdha natyrore, këto zona njihen edhe për leksikun e veçantë. Vlen të përmendet se, edhe pse si pjesë janë të përbashkëta, apo gjenden afër njëra tjetrës me “kufij” shumë të lirë, prapëseprapë, secili vend i ka veçantitë e veta.

Leksiku, është mjaft i pasur me fjalë të shumta, që ndodh të fliten në një fshat, ndërsa në tjetrin të zëvendësohet më një fjalë tjetër. Një numër i madh fjalësh të cilat i gjejmë në përdorim aktiv në këto hapësira gjeografike, tashmë janë edhe pjesë e leksikut të gjuhës standarde shqipe, por në anën tjetër, kemi edhe shumë të tjera të cilat fliten, por janë jashtë leksikut standard.

Shqipja konsiderohet shumë e pasur sa i takon fjalëformimit.

Ndër më të dalluarat janë ato me prapashtesën *-ejk*, po ashtu i veçantë është edhe theksimi i fjalëve duke rënë fonema *-ë*, si p.sh.: *i Reks*, *i Pej*s, *i Gjakovs*, *supa puls*, etj.

Pra, si përfundim mund të themi se në të folmen e Kosovës Perëndimore dhe Jugperëndimore, si dhe në mbarë shqipen, mjetet kryesore të fjalëformimit janë prapashtesat.